

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPALLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Drejtor, Drejtorja e Kontrollit të Terrenit, Tirana -Veri (Kategoria II-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); VKB nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Drejtori i Drejtorisë ka për detyrë si më poshtë:

Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Terrenit, Tirana-Veri, varet nga Kryeinspektori dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Raporton periodikisht (raporte ditore, javore e mujore) tek Kryeinspektori për masat e marra dhe punën e kryer nga grupet e inspektorëve;
- Organizon, koordinon dhe drejton punën e drejtorisë, nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve;
- Bashkërendon punën mes IMT dhe institucioneve të tjera shtetërore për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të parandalimit të ndërtimeve të paligjshme;
- Harton planin e masave administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të strukturave të IMT, për evidentimin e ndërtimeve të paligjshme në territorin e Bashkisë Tiranë;
- Bashkërendon punën me strukturat e tjera të IMT për të mundësuar zbatimin e planeve ditore të punës të grupeve të inspektorëve;
- Bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale të depozituara nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit;

- Organizon shpërndarjen e inspektorëve në grupet e inspektimit sipas Njësive Administrative Zonale;
- Kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi nga Inspektorët e IMT;
- Përgjigjet për realizimin e objektivave të vendosura;
- Verifikon dhe firmos të gjithë aktet në emër të drejtorisë;
- Përgjigjet për zbatimin e rregullores së Brendshme nga punonjësit në varësi;
- Harton planet e punës duke vendosur prioritete dhe i miraton tek Kryeinspektori si dhe ndjek zbatimin e tyre;
- Analizon punën e drejtorisë dhe jep mendime për mënyrën e zgjidhjes së problematikave;
- Kontrollon dhe verifikon veprimtarinë e punës të të gjitha strukturave të Njësive zonale dhe në rast të konstatimeve të shkeljeve i propozon Kryeinspektorit marrjen e masave.

Dokumentat që aplikanti për Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit të Terrenit, Tirana - Veri, duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (për diplomat jashtë vendit të përcillet njëhësi nga MAS) ;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 05.09.2024 **ora** 16.30.